



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

# BULETINI STATISTIKOR

JANAR - DHJETOR 2023



## Tabela e Lëndës

1	Treguesit kryesorë të veprimtarisë audituese
2	Konkluzionet në Auditimet e TI
3	Mesazhet në Auditimet e Performancës
4	Niveli i Pranueshmërisë së Rekomandimeve
5	Zhvillimi dhe Menaxhimi i Burimeve Njerëzore
6	Programi i Transparencës dhe e Drejta për Informim
7	Auditime në media
8	Anekse



## AKRONIME

ANAC - Autoriteti Kombëtar Italian i Anti-Korrupsionit

APP - Agjencia e Prokurimit Publik

AKSHI - Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit

ECA - Gjykata Evropiane e Audituesve

EUROSAI - Organizata Evropiane e Institucioneve Supreme të Auditimit

GAO - Zyra e Përgjegjshmërisë Qeveritare, SHBA

ISSAI - Standardet Ndërkombëtare të Auditimit

IMTV - Inspektorati Vendor i Mbrojtjes të Territorit

ISHTI - Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial

KLSH- Kontrolli i Lartë i Shtetit

OECD - Organizata për Bashkëpunimin Ekonomik dhe Zhvillimin

RASH - Rrjeti Akademik Shqiptar

SAI - Institucione Supreme të Auditimit

TIK - Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit

TI - Teknologjia e Informacionit

UK - Ujësjellës Kanalizime

ISHTI - Inspektorati Shtetëror Teknin dhe Industrial

ISSH - Instituti i Sigurimeve Shoqërore

DPSHTRR - Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor

# AKTIVITETI I KLSH PËRMES SHIFRAVE




\* Në 2 auditime nuk janë dhënë opinione mbi pasqyrat financiare

# 1. TREGUESIT KRYESORË TË VEPRIMTARISË AUDITUESE

## 1.1 Auditimet sipas llojit

Kontrolli i Lartë i Shtetit, për periudhën janar-dhjetor 2023, ka vijuar punën audituese në zbatim të planit të miratuar me vendimin nr.234 datë 16.12.2022 të Kryetarit të KLSH, duke kryer dhe evaduar 160 misione auditimi, në vlerësim të përputhshmërisë, rregullshmërisë financiare, performancës dhe ndjekjes së statusit të zbatimit të rekomandimeve të lëna në periudha të mëparshme. Detajuar sipas llojit të auditimit, aktiviteti auditues paraqitet në tabelën në vijim:

**Infografik nr. 1:** Misionet e auditimit të evaduara, në numër dhe përqindje ndaj totalit



## 1.2 Institucionet ku janë kryer auditimet

Në periudhën janar - dhjetor 2023, auditimet e kryera kanë përfshirë vlerësimin e aktivitetit në 195\* subjekte duke përfshirë nivele të ndryshme të qeverisjes si : institucione qendrore, ministri dhe agjenci (përfshirë drejtori qendrore dhe rajonale në varësi të tyre), njësi të vetëqeverisjes vendore, drejtori të përgjithshme të administrimit fiskal, si dhe shoqëri aksionere me kapital shtetëror në të cilat shteti zotëron mbi 50% të aksioneve, apo projekte me financim të huaj.

**Infografik nr. 2:** Kategoritë e institucioneve të audituara, në numër



\*Auditimet e performancës dhe IT mund të përfshijnë subjekte në të cilat është kryer gjithashtu edhe auditim financiar dhe/ose auditim përputhshmërie.

### 1.3 Opinionet/mesazhet/konkluzionet sipas llojit të auditimit

Bazuar në planin vjetor 2023, Kontrolli i Lartë i Shtetit, për periudhën Janar – Dhjetor 2023, ka përfunduar kryerjen e 160 auditimeve, duke dhënë:

- 185 opinione\* për 121 auditime financiare & përputhshmërie, nga të cilat: 71 financiare, 114 përputhshmërie;
- 16 mesazhe auditimi për 17 auditime performance;
- 8 konkluzione për 8 auditime IT;
- 14 konkluzione në 14 auditime tematike, të përputhshmërisë për çështje të veçanta.

**Infografik nr. 3:** Opinionet/mesazhet/konkluzionet



\*Përfshirë këtu 4 konkluzione

Opinionet, mesazhet dhe konkluzionet e auditimit, të ndara sipas llojit të auditimit, paraqiten në tabelën më poshtë:

Tabela nr.1: Opinionet/mesazhet/konkluzionet sipas llojit të auditimit

Lloji i auditimit	Lloji i opinionit		Të tjera		Total
	I modifikuar	I pamodifikuar	Konkluzione	Mesazhe	
Financiar	51	18	2	-	71
Përputhshmërie	102	10	2	-	114
IT	-	-	8	-	8
Performance	-	-	-	16	16
Përputhshmërie (për çështje te vecanta)	-	-	14	-	14
<b>Total</b>	<b>153</b>	<b>28</b>	<b>26</b>	<b>16</b>	<b>223</b>

Mbështetur në standardet ndërkombëtare të auditimit (ISSAI 100), në baze të gjetjeve të konkluduara mbi evidencat e auditimit, materialitetit dhe përhapjes, opinioni i dhënë mund të jetë “i modifikuar” ose “i pamodifikuar”. Në vijim:


Opinionet e pamodifikuar mund të jenë:

- të pakualifikuar, ose
- të pakualifikuar me theksim çështje

Opinionet e modifikuar mund të jenë:


- të kualifikuar, ose
- të kundërt, ose
- refuzues

**Infografik nr. 4:** Ndarja e opinionëve, mesazheve dhe konkluzioneve sipas llojit



\*1 auditim performance nuk ka konkluduar në mesazh auditimi

## 1.4 Rekomandimet sipas natyrës



### 1.4.1 Përmirësime ligjore & Masa organizative

Gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2023, për 160 auditimet e përfunduara, KLSH ka adresuar rekomandime për 3293 masa organizative dhe 42 propozime për ndryshime apo përmirësime ligjore, në institucionet publike të audituara, me qëllim marrjen e masave për përmirësimin e situatës, të paraqitura më hollësisht në tabelën në vijim:

**Tabela nr.2:** Përmirësime ligjore dhe masa organizative

Grupet e institucioneve	Nr. auditimesh	Masa organizative	Përmirësime ligjore
Institucione të pavarura, të qeverisjes qendrore dhe të varësisë	34	750	18
Institucione të administrimit të aseteve dhe mbrojtjes së mjedisit	11	213	1
Institucione të vetëqeverisjes vendore dhe njësi të tjera në nivel vendor	69	1513	-
Shoqëri publike dhe projekte me financim të huaj	18	408	2
Institucione në të cilat janë kryer auditimet e performancës	18	252	19
Institucione në të cilat janë kryer auditimet e TI	10	157	2
<b>Total</b>	<b>160</b>	<b>3293</b>	<b>42</b>

Rekomandimet për përmirësime ligjore janë dhënë:

(i) në fushën e drejtësisë për çështje që lidhen me: kriteret e pranimit në Policinë e Burgjeve; dhe me ndihmën juridike të ofruar nga shteti mbi ofrimin e kushteve dhe garantimin e të drejtave për të paraburgosurit;

(ii) në fushën e mbrojtjes së sipërmarrjes për rishikimin dhe ridimensionimin e rolit të Ministrisë të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes në drejtim forcimit të promovimit, zhvillimit dhe koordinimit të politikave shtetërore në mbështetje të start-upeve dhe ekosistemit të tyre;

(iii) në fushën e medias audiovizive për çështje ligjore që lidhen me përmirësimin e kuadrit nënligjor për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë si dhe bashkërendimin me akte ligjore dhe nënligjore për funksionimin e organeve kolegiale të administratës shtetërore dhe enteve publike.

(iv) në fushën e administrimit të aseteve sa i takon kadastrës për çështje që lidhen me përcaktimin e nivelit tavan të sipërfaqes së truallit funksional nga 300 m<sup>2</sup>-500 m<sup>2</sup>, duke patur si prioritet përcaktimet ligjore për konceptin e truallit funksional, me qëllim shmangien e zaptimeve të pasurive shtetërore dhe abuzimeve të mundshme në këtë drejtim dhe përcaktimin e rregullave të hollësishme për miratimin e dokumentit të pronësisë, të objekteve pa titull pronësie, trojeve të tyre funksionale dhe të oborreve në përdorim;

(v) në fushën e transportit për plotësimin e legjislacionit në përputhje me praktikën më të mira ndërkombëtare si dhe forcimin e mëtejshëm të sistemit të monitorimit të cilësisë së ajrit. Mbi promovimin e mjeteve të transportit rrugor të pastër dhe me energji eficiente” dhe Direktivës 2014/94/BE e Parlamentit dhe Këshillit Evropian e “Mbi vendosjen e infrastrukturës së karburanteve alternative”;

(vi) në fushën e rezervave materiale të shtetit për rishikimin e kuadrit ligjor e rregullator mbi administrimin e mjeteve të konfiskuara;

(vii) në fushën e shëndetësisë për të rishikuar mundësinë e përmirësimit të ligjit "Për transplantimin e indeve, të qelizave dhe të organeve në Republikën e Shqipërisë" sipas praktikave më të mira evropiane e botërore për transplantin e kryqëzuar të veshkave.

(viii) në fushën e drejtësisë për çështje që lidhen me: kriteret e pranimit në Policinë e Burgjeve; dhe me ndihmën juridike të ofruar nga shteti mbi ofrimin e kushteve dhe garantimin e të drejtave për të paraburgosurit;

(ix) në fushën e mbrojtjes së sipërmarrjes për rishikimin dhe ridimensionimin e rolit të Ministrit të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes në drejtim forcimit të promovimit, zhvillimit dhe koordinimit të politikave shtetërore në mbështetje të start-upeve dhe ekosistemit të tyre.

(x) në fushën e shërbimeve të jashtme të RSH për harmonizimin dhe plotësimin e kuadrit ligjor dhe nënligjor mbi shërbimin e jashtëm, duke marrë masat për një zbatimin të plotë dhe efektiv të parimit të ekskluzivitetit, dhe të ndërmerren masat e nevojshme për të iniciuar amendime në Ligjin nr.23/2015 “Për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Shqipërisë”.

(xi) në fushën e çështjeve sociale, sa i takon:

- viktimave të dhunës në familje, ku diktohet nevoja e ashpërsimit të legjislacionit, për vënien përpara përgjegjësisë administrative dhe penale të përfaqësuesve të institucioneve qendrore e vendore, që nuk përmbushin detyrimet ligjore për parandalimin e dhunës në familje dhe masavembrojtëse, në veçanti kur nga mosveprimet e tyre janë shkaktuar dëmtime të rënda në marrëdhëniet familjare ose viktimat.
- plotësimin e kuadrit nënligjor për funksionimin më të mirë të sistemit të shërbimeve të kujdesit shoqëror, duke hartuar dhe propozuar akte ligjore e nënligjore për zbatimin të nenit 23.3 dhe nenit 23.4 dhe nenit 46 pika 2 dhe të Ligjit nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, për përcaktimin e kriterëve për përfituesit e shpenzimeve personale të shërbimeve dhe pagesat e tarifave shërbimeve që ofrohen nga kontributet e përfituesve të shërbimeve të kujdesit shoqëror, të përcaktuara në nenin 23 të këtij ligji.


(xii) në fushën e kontabilitetit ku kërkohet që Ministria i Financave dhe Ekonomisë, si autoriteti shtetëror përgjegjës të orientojë drejt krijimit, organizimit dhe funksionimit të sistemit të kontabilitetit të detyrueshëm për të gjitha njësitë e qeverisjes së përgjithshme, që të hartohet ligji mbi kontabilitetin dhe raportimin financiar në sektorin publik, në përputhje me standardet ndërkombëtare të pranuar; si edhe

(xiii) në fushën e mjedisit, në hartimin dhe propozimin për miratim pranë organeve kompetente akte ligjore/nënligjore për të transpozuar Direktivën 2009/33/KE e Parlamentit dhe Këshillit Evropian e datës 23 prill 2009 “Mbi promovimin e mjeteve të transportit rrugor të pastër dhe me energji eficiente” dhe Direktivës 2014/94/BE e Parlamentit dhe Këshillit Evropian e datës 22 Tetor 2014 “Mbi vendosjen e infrastrukturës së karburanteve alternative”.


**Infografik nr. 5:** Rekomandimet për përmirësime ligjore



**Infografik nr. 5: (vazhdon) Rekomandimet për përmirësime ligjore**




**Infografik nr. 5: (vazhdon) Rekomandimet për përmirësime ligjore**



## 1.4.2 Gjetje me efekte negative në të ardhura dhe shpenzime

Gjatë periudhës Janar - Dhjetor 2023, janë dhënë 689 rekomandime mbi gjetje me efekte negative në buxhetin e shtetit, për total vlerën 72,386,606 mijë lekë, nga të cilat: dëmi ekonomik vlerësuar 5,170,489 mijë lekë, menaxhimi jo efektiv i fondeve në vlerën 64,892,630 mijë lekë dhe 2,323,487 mijë lekë në mangësi në aktivitetin kontrollues tatimor/doganor

**Infografik nr. 6:** Efektet negative financiare ne buxhet sipas fushave kryesore (ne '000 lekë)




Rreth 1.2% e efekteve financiare me pasojë **dëm ekonomik\*** në buxhetin e shtetit (ose 59,285 mijë lekë) është konstatuar në fushën e të ardhurave, ndërsa rreth 98.8%, në fushën e shpenzimeve (5,111,204 mijë lekë) ku:

- rreth 61% të totalit të shpenzimeve e zë vlera 3,027,968 mijë lekë, e konstatuar në subjektin Albpetrol SHA Patos, si pasojë e detyrimeve që kanë shoqëritë koncensionare ndaj shoqërisë për energjinë e shitur/faturuar me dhe pa kontrata;
- rreth 27% e totalit të shpenzimeve, ose 1,368,491 mijë lekë është konstatuar përsëri në subjektin Albpetrol SHA Patos, si pasojë e maturimit të penalteteve e kamatëvonesave për mos kryerjen e pagesave për energjinë elektrike nga kompania Bankers Petroleum;
- rreth 4% e totalit të shpenzimeve e zënë vlerat në "Shpenzime për paga dhe shpërblime", në shumën 181,800 mijë lekë, si pasojë e pagesave gjoba dhe kamatvonesa në lidhje me detyrimet për sigurimet shoqerore dhe shëndëtesore si dhe përfitimin padrejtësisht të shpërblimeve për anëtarët e vetë;
- rreth 8% e totalit të shpenzimeve i takojnë zërit "Shpenzime në procedura prokurimi dhe zbatim punimesh" në shumën 386,624 mijë lekë, ku renditen subjektet si: KESH sha - 21,981 mijë lekë, AKSHI - 18,442 mijë lekë, QSUT - 65,230 mijë lekë, Bashkia Mat - 43,257 mijë lekë, Bashkia Peqin - 18,921 mijë lekë, UKT SHA - 15,457 mijë lekë, Albpetrol SHA Patos - 14,172 mijë lekë, dhe Hekurudha Shqiptare SHA - 10,786 mijë lekë, etj.

\*Vlera e detajuar e dëmit ekonomik sipas subjekteve, gjendet e pasqyruar në Aneksin nr. 4, Tabela 4.1

Sa i takon **menaxhimit jo efektiv të fondeve\*\***, vlera totale prej 64,892,630 mijë lekë u konstatua:

- **në fushën e të ardhurave** në vlerën prej prej 18,739,529 mijë lekë (ose rreth 29% e totalit) ku veçojmë: (i) vlerën 5,721,500 mijë lekë në AlbPetrol SHA si detyrime që koncensionarët kanë ndaj AlbPetrol SHA, krijuar prej diferencave të çmimit real të shitjes me çmimin e produkteve në momentin e lindjes së detyrimit kontraktor; (ii) vlerën 5,643,173 mijë lekë në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, si pasojë e mos shlyerjes së detyrimeve përkatëse në kuadër të marrëveshjes së nënhuasë; si dhe (iii) vlerën 4,605,498 mijë lekë në njësitë e vetëqeverisjes vendore, si pasojë e mos arkëtimit të taksave dhe tarifave vendore; dhe
- **në fushën e shpenzimeve** në vlerën prej 46,153,101 mijë lekë (ose rreth 71%), si rezultat i shkeljeve të disiplinës buxhetore lidhur me likuidimin e shpenzimeve, keqmenaxhimin e fondeve të programuara apo mungesë kontrolli në realizimin e procedurave të prokurimit jo në përputhje me kuadrin ligjor, ku veçojmë vlerën prej 40,120,939 mijë lekë (ose rreth 87% e total menaxhimit jo efektiv të fondeve) raportuar në zërin “Shpenzime të tjera”, peshën më të madhe të të cilit (ose rreth 96%) e zë vlera 38,530,602 mijë lekë, e konstatuar në Ministrinë e Financave, si pasojë e krijimit të detyrimeve të prapambetura. Pjesa tjetër e këtyre fondeve përbëhet nga shkelje të konstatuara në fushën e prokurimeve & koncesioneve (4,406,549 mijë lekë), si dhe në shpenzime operative (1,625,613 mijë lekë).



→ 2,323,487 mijë lekë në fushën e të ardhurave

dhe rregullator në strukturën përgjegjëse të hetimit, antikontrabandës, akcizës etj; (iii) në Drejtorinë e Tatimpaguesve të Mëdhenj, si pasojë e faturimeve të situacioneve të punimeve ndërtimore nën nivelin e përcaktuar në EKB, mangësive në inventar, shitjeve pa faturë tatimore, kreditim i gabuar i TVSH-së së karburantit, zbatimit të gabuar të koeficientit të rregullimit të TVSH-së, shitjeve të objekteve ndërtimore poshtë çmimit të referencës të përcaktuar në kuadrin ligjor, etj.

KLSH, për periudhën Janar – Dhjetor 2023, ka konstatuar **mangësi në aktivitetin kontrollues tatimor & doganor** me ndikim negativ në performancën e administrimit të të ardhurave tatimore & doganore, si detyrime dhe penaltete të vlerësuara në vlerën 2,323,487 mijë lekë, konstatuar: (i) në Drejtorinë Rajonale Tatimore Durrës, si pasojë e parregullsive në procedurën e kontrollit tatimor, diferenca midis pajisjes fiskale/FDP dhe mosvendosjes së penalteteve për bizneset që nuk kanë paguar këstet e tatim fitimit sipas afatit ligjor; (ii) në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, si pasojë e problematikave të identifikuar në zbatimin e kuadrit ligjor, nënligjor

\*\*Vlera e detajuar e menaxhimit jo efektiv sipas subjekteve, gjendet e pasqyruar në Aneksin nr. 4, Tabela 4.1

Tabela në vijim paraqet vlerën e dëmit ekonomik dhe atë të menaxhimit jo efektiv të fondeve, të organizuar sipas fushave ku është konstatuar parregullsia:

Tabela nr 3: Efektet financiare negative sipas fushave (në '000 lekë)


<b>Efekte negative financiare</b>	<b>Dëm ekonomik</b>	<b>Menaxhim jo efektiv</b>	<b>Ndikim negativ tatime/dogana</b>	<b>Total</b>
<b>Shpenzime</b>	<b>5,111,204</b>	<b>46,153,101</b>	-	<b>51,264,304</b>
Koncesione	-	33,020	-	<b>33,020</b>
Procedura prokurimi	33,426	3,457,652	-	3,491,079
Shpenzime operative	1,388,536	185,334	-	1,573,870
Shpenzime për paga & sig. shoqërore	181,800	1,440,279	-	1,622,079
Shpenzime të tjera	3,154,244	40,120,939	-	43,275,183
Zbatim punimesh	353,198	915,876	-	1,269,074
<b>Të ardhura</b>	<b>59,285</b>	<b>18,739,529</b>	<b>2,323,487</b>	<b>21,122,301</b>
Detyrime tatimore të vlerësuara	-	-	1,629,845	1,629,845
Koncesione	49,999	3,835	-	53,834
Penalite të vlerësuara	-	-	693,642	693,642
Të ardhura në urbanistikë	689	400,117	-	400,806
Të ardhura nga qiratë/PPP/shitje	1,545	1,344,647	-	1,346,192
Të ardhura të tjera	-	12,385,432	-	12,385,432
Shkelje e legjislacionit tatimor në qeverisjen lokale	7,052	4,605,498	-	4,612,550
<b>Total</b>	<b>5,170,489</b>	<b>64,892,630</b>	<b>2,323,487</b>	<b>72,386,606</b>

## 1.5 Masa disiplinore dhe administrative

Bazuar në Ligjin nr. 154, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, KLSH, për të metat dhe shkeljet e konstatuara, ka adresuar tek subjektet e audituara 1468 rekomandime për masa administrative dhe disiplinore, nga të cilat 1399 masa disiplinore dhe 69 administrative.

Konkretisht, për shkeljet e konstatuara në bazë të ligjit të mësipërm, Ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, neni 58 dhe Kodit të Punës, KLSH u ka kërkuar organeve respektive shqyrtimin dhe marrjen e 1173 masave disiplinore (pasi për 226 masa të tjera, punonjësit kanë rezultuar të larguar nga puna).


**Infografik nr. 7:** Masat disiplinore sipas ligjit për nëpunësin civil dhe sipas kodit të punës



Bazuar në Ligjin Nr.154, atë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, KLSH, për të metat dhe shkeljet e konstatuara, ka adresuar tek subjektet e audituara 69 masa administrative.

Konkretisht, për shkeljet e konstatuara, KLSH u ka kërkuar organeve respektive (APP, IMTV, Inspektoratit Ndërtimor, Urbanistik dhe Ministrisë së Linjës) shqyrtimin dhe marrjen e 69 masave administrative, si në infografikun më poshtë:

**Infografik nr. 8:** Masat administrative



## 2. KONKLuzionet në Auditimet e TI



### UJËSJELLËS - KANALIZIME SH.A TIRANË (UK SHA)

Ka munguar strategjia, politikat dhe aktet rregullative që përcaktojnë drejtimin, përgjegjësitë dhe detyrimet mbi përdorimin e Teknologjisë së Informacionit në shoqërinë UK sha, Tiranë. Gjithashtu, ka munguar një planifikim dhe zhvillim në shërbime të reja informatike, për arritjen e objektivave institucionale. Hapat e ndërmarrë në drejtim të rritjes së përdorimit, përmirësimit dhe sigurisë së shërbimeve që ofrohen nëpërmjet teknologjisë së informacionit, janë të pamjaftueshëm për të hyrë në procesin e sigurisë së të dhënave dhe vazhdimësisë së ofrimit të shërbimeve pa ndërprerje. Edhe pse nuk ka pasur problematika të mëdha në të dhënat elektronike, mundësia për humbjen e tyre, ndërprerjen apo tjetërsimin, është e lartë.



### RRJETI AKADEMIK SHQIPTAR

Rrjeti Akademik Shqiptar është i vetmi institucion në vend që ka zhvilluar dhe ndërtuar disa sisteme informatike me programues, të cilët janë punonjës të institucionit, duke ofruar zgjidhje në informatizimin e proceseve të administrimit të brendshëm dhe akademik të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe informatizime të rëndësishme për Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

Për Rrjetin Akademik Shqiptar nuk është financuar asnjë e ardhur nga buxheti i shtetit apo buxhetet e universiteteve, me qëllim mirëmbajtjen dhe zhvillimin e mëtejshëm të sistemeve informatike që ka ndërtuar dhe ofron për Institucionet e Arsimit të Lartë dhe Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

Nga Ministria e Arsimit dhe Institucionet e Arsimit të Lartë Publik, megjithëse si institucione themeluese të RASH, nuk është zbatuar pika 5/c e VKM nr.88, datë 14.02.2018, në të cilën ato përcaktohen si burime të financimit të Qendrës Ndërinstitucionale të Rrjetit Akademik Shqiptar, duke vendosur institucionin në kushtet e riskut të ekzistencës së tij dhe të zhvillimeve e produkteve informatike të rëndësishme që ka ofruar deri tani.



## INSTITUTI I SIGURIMEVE SHOQËRORE

Investimet në sistemet e informacionit nuk kanë zgjidhur problemet e sigurisë së informacionit, si dhe sigurimin e vazhdueshmërisë së biznesit. Zhvillimi i shërbimeve dhe infrastrukturës nuk është mbështetur në praktikat më të mira.

Pajisjet fizike, programet softuerike, të cilat ndërveprojnë në mënyrë që sistemet të operojnë, janë të pa përditësuara (në fund të jetës) e nuk ofrohet suport nga prodhuesi. Nga auditimi i sistemeve kryesore, duke u bazuar në performancën e veprimeve me tregues si: koha e përgjigjes, koha e përpunimit, përdorimi i burimeve të sistemit, komentet e përdoruesve, rezultoi se sistemet i përgjigjen me vonesë kërkesave të përdoruesve.

Identifikimi dhe administrimi i elementëve kritikë në ofrimin e shërbimeve dhe garantimin e sigurisë së të dhënave, si dhe të vazhdimësisë në ofrimin e shërbimit nëpërmjet Teknologjisë së Informacionit është i pamjaftueshëm.

ISSH nuk ka marrë masa për kalimin e strukturave përgjegjëse TIK tek AKSHI, si dhe dorëzimin e Sistemeve dhe Infrastrukturës TIK ekzistuese nën administrimin dhe inventarin e AKSHI-t, së bashku me të drejtat dhe detyrimet juridiko-civile



## INSPEKTORATI SHETËROR TEKNIK DHE INDUSTRIAL

Mungesa e strategjisë, akteve rregullative, pajisjeve kompjuterike dhe internetit në tabletat për inspektim, problematikat në funksionalitetet e sistemit “e-inspektimi”, janë disa nga faktorët kryesorë që kanë ndikuar në cilësinë dhe saktësinë e të dhënave që gjeneron Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial.

Sistemi e-inspektimi vazhdimisht punon me ndërprerje dhe ka probleme gjatë procesit të inspektimit duke ndikuar negativisht në veprimtarinë e punës së inspektorëve në ofrimin e shërbimeve kundrejt bizneseve dhe qytetarëve.

Identifikimi dhe administrimi i elementëve kritikë në infrastrukturën netëorë dhe atë kompjuterike është i pamjaftueshëm, si dhe shërbimet që ofron teknologjia e informacionit në ISHTI mbështeten në një infrastrukturë IT jo të konsoliduar.



## DREJTORIA E PËRGJITHSHME E SHËRBIMEVE TË TRANSPORTIT RRUGOR

Kemi vlerësuar se është e cënuar siguria e të dhënave, në sistemet informatike ku ruhen të dhënat e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit dhe Transportit Rrugor dhe mundësia e institucionit për të marrë masa përmirësuese është e kufizuar për shkak të bashkëpërgjegjësisë që ka në drejtim të teknologjisë me AKSHI-n. Me rëndësi është situata e mungesës së strukturës së dedikuar nga AKSHI që i shërben sigurisë së informacionit si dhe mungesa e marrëveshjes në terma teknike ndërmjet institucioneve, e mbështetur në aktet ligjore e nënligjore në fuqi.

Megjithëse DPSHTRR është penalizuar nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, për rrjedhjen e të dhënave të regjistrit të mjeteve, nuk është vepruar në marrjen e masave organizative dhe teknike që ka secili prej institucioneve DPSHTRR dhe AKSHI në procesin e sigurisë së të dhënave dhe sigurisë kibernetike



## RADIO TELEVISIONIN SHQIPTAR

Kemi vlerësuar se Investimet në sistemet e informacionit nuk kanë zgjidhur problemet e sigurisë së informacionit, si dhe sigurimin e vazhdueshmërisë së biznesit.

Zhvillimi i sistemeve ndër vite nuk është zhvilluar sipas një planifikimi strategjik afatgjatë. Si rezultat i investimeve në sisteme të reja, disa prej sistemeve ekzistuese nuk gjejnë më përdorim pasi funksionalitetet e tyre janë zëvendësuar nga sisteme të reja. Investimet në sistemet e reja kanë shfaqur një sërë problematikash të cilat lidhen me kapacitetin storage, duke vështirësuar menaxhimin e sistemit dhe mundësinë për ndërprerje dhe mosfunksionim i sistemit në të ardhmen.

Shërbimet që ofron teknologjia e informacionit në RTSH mbështeten në një infrastrukturë IT jo të konsoliduar, duke ndikuar negativisht dhe në shërbimet e ngritura mbi këtë rrjet. Paisjet fizike, programet softuerike të cilat ndërveprojnë në mënyrë që sistemet të operojnë, janë të papërditësuara e nuk kanë suportin e prodhuesit.

Në opinionin tonë, pas shqyrtimit të evidencave të marra, identifikimi dhe administrimi i elementëve kritikë në ofrimin e shërbimeve dhe garantimin e sigurisë së të dhënave, si dhe të vazhdimësisë në ofrimin e shërbimit nëpërmjet Teknologjisë së Informacionit është i pamjaftueshëm.

### 3. MESAZHET NË AUDITIMET E PERFORMANCËS



#### FUQIZIMI EKONOMIK I GRUAS NË VENDIN TONË


Vendosja e parimit të barazisë gjinore si një parim thelbësor i ciklit buxhetor, është e vetmja rrugë e duhur për të rrënjësuar kulturën e barazisë gjinore në vendin tonë. Për këtë qëllim, institucionet duhet të angazhohen maksimalisht në drejtim të:

- rritjes së impaktit të buxhetimit të përgjigjshëm gjinor;
- promovimit dhe vendosjes së treguesve të matshëm sasior e cilësor gjinor në buxhetet e institucioneve;
- koordinimit midis institucioneve për zbatimin e strategjive të barazisë gjinore dhe integrimin e tyre me strategjitë sektoriale;
- monitorimit të saktë të këtyre politikave për të konkretizuar angazhimin e grave në të gjitha fushat e ekonomisë së vendit tonë që sigurojnë fuqizimin e tyre.



#### PERFORMANCA E SHËRBIMIT TË PARABURGIMIT

Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve dhe Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale duhet të luajnë një rol proaktiv në garantimin e të drejtave të shtetasve të paraburgosur, nëpërmjet krijimit të një qasje të re, me qëllim ruajtjen e shëndetit të tyre, vetë respektit dhe dinjitetit njerëzor. Sistemi penitenciar ka nevojë edhe për një bashkëveprim më dinamik ndërmjet institucioneve shtetërore përgjegjëse, veçanërisht midis Policisë së Shtetit dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve.



## TË ARDHURA NGA TAKSAT DHE TARIFAT E BASHKIVE PËR MENAXHIMIN E PANDEMISË

Bashkitë kanë një autonomi financiare jo të mirë për shkak se pjesa më e madhe e fondeve ju vijnë nga transfertat e pa kushtëzuara dhe të kushtëzuara, ndërkohë që fondet nga të ardhurat e veta janë të pa mjaftueshme për funksionimin e tyre.

Shpenzimet e kryera gjatë vitit 2020 për menaxhimin e pandemisë, krahasuar me totalin e shpenzimeve, rezultuan të jenë në masën 2%.

- Bashkitë nuk kanë hartuar një plan për rimëkëmbjen sa i përket pasojave të pandemisë Covid-2019.
- Procesi i rimëkëmbjes nuk identifikohet përmes një fondi të veçantë por vijon të mbetet një koncept abstrakt për emergjencat civile të bashkive.
- Situata e krijuar nga pandemia është menaxhuar nga pushteti qendror, bashkitë thjeshtë kanë vepruar në përshtatje me rregullat e miratuara, duke mos u angazhuar për miratimin e rregullave të tjera për ofrimin e shërbimeve operationale, specifike për karakteristikat e secilës bashki.



## SHËRBIMI NË TERAPINË RENALE ZËVENDËSUESE

Ministra e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në bashkëpunimin dhe koordinimin me institucionet spitalore dhe Fondin e Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor të rrisin vëmendjen për përmirësimin e politikave të kujdesit shëndetësor në nivel kombëtar dhe rajonal, për depistimin dhe parandalimin e sëmundjeve kronike të veshkave, përmirësimin në shërbimin e Terapisë Renale Zëvendësuese (hemodializa, dializë peritoneale, transplant), monitorimin periodik të ofrimit të shërbimit dhe të protokolleve të shërbimit si dhe trajnimin dhe kualifikimin e stafit mjekësor, në mënyrë të vazhdueshme dhe në përshtatje me zhvillimet më të fundit shkencore, duke ndikuar në cilësinë e jetës dhe jetëgjatësinë e pacientëve të prekur me sëmundjet kronike të veshkave.



## SHËRBIMI PËRMBARIMOR SHTETËROR NË EKZEKUTIMIN E VENDIMEVE GJYQËSORE

Për të siguruar mirë funksionimin e sistemit të përmbarimit shtetëror, Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarimit duhet të krijojë një frymë të bashkëpunimi me të gjitha institucionet e përfshira në ekzekutimin e vendimeve, në përputhje me ligjin e ri organik, në drejtim të rritjes së cilësisë së ekzekutimit të vendimeve gjyqësore, garantimit të të drejtave të qytetarëve dhe përmirësimit të shërbimit të ofruar



## REZERVAT E SHTETIT NË SHËRBIM TË QYTETARIT

Institucionet përgjegjëse duhet të përdorin gjithë instrumentet në dispozicion për të përmbushur pritshmërinë e qytetarit lidhur me sigurinë që ato duhet të ofrojnë për jetën dhe shëndetin e tyre.

Rezerva materiale e shtetit, si një garanci për qytetarin, duhet të përmbushë plotësisht misionin për të cilin është krijuar.

Kalimi nën përgjegjësinë e Ministrisë së Mbrojtjes, duhet të sjellë zhvillime pozitive, të cilat t'i shërbejnë forcimit të rolit të saj. Burimet njerëzore dhe financiare duhet të fokusohen drejt aktivitetit parësor për përballimin e situatave të parashikuara. Asetet e trashëguara, pasuri kombëtare, duhet të administrohen për të qenë një vlerë e shtuar në rezervën materiale të shtetit.

Parë nga perspektiva e zhvillimeve gjeopolitike dhe ndryshimeve klimaterike dhe demografike, përmbushja e kufijve minimalë të përcaktuar të rezervës materiale e shtetit, duhet të jetë garanci për qytetarin.



## NDIKIMI I MJETEVE TË TRANSPORTIT RRUGOR NË CILËSINË E AJRIT

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjetikës së bashku me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit të nxisin rinovimin e flotës së mjeteve rrugore, vënie në zbatim të stimujve financiare për të shtuar numrin e mjeteve rrugore me emetim të ulët, plotësimin e legjislacionit në përputhje me praktikat më të mira ndërkombëtare si dhe forcimin e mëtejshëm të sistemit të monitorimit të cilësisë së ajrit.



## TRAJTIMI I SËMUNDJEVE TUMORALE

Ministra e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe institucionet shëndetësore, për shkak edhe të numrit në rritje të pacientëve me sëmundje tumorale, krahas punës së vazhdueshme në promovimin e stilit të jetës së shëndetshme, të nxisin, politikat e parandalimit, depistimit, trajtimit në kohë të kancerit dhe uljes së mortalitetit të popullsisë në vend.

Arritja e parandalimit të sëmundjeve tumorale në fazën e hershme të tyre nëpërmjet bashkërendimit të politikave shëndetësore, rritjes së buxheteve financiare, sigurimit të pajisjeve mjekësore, shtimit të ambienteve spitalore, plotësimit me medikamente si dhe përmirësimit të strukturave të dedikuara me personel mjekësor të mirëkualifikuar të jetë një sfidë e vazhdueshme për institucionet shëndetësore.

---



## SHËRBIMI I POLICISË NË PËRGJIGJE TË QYTETARËVE

Drejtoria e Përgjithshme e Policisë Shtetit dhe strukturat e varësisë të nxisin një angazhim të vazhdueshëm e qëndrueshëm në përmirësimin e ofrimit të shërbimit sa më cilësor ndaj qytetarëve, duke kërkuar: procedura e rregulla të qarta dhe të njohura nga të gjithë punonjësit e policisë e qytetarët; ndërtimin e një sistemi efikas për të pranuar dhe trajtuar ankesat e qytetarëve; shtrirjen, përdorimin dhe përgjigjen në kohën më të shkurtër të telefonatave nëpërmjet numrit të unifikuar të emergjencave 112 dhe mirë administrimin e tij; monitorimin e veprimeve të policisë në linjë me parimet e policimit në komunitet, në mbrojtje dhe respektim të drejtave të njeriut, si objektiva të rëndësishëm në ndërtimin e një shoqërie të sigurt dhe të drejtë për të gjithë qytetarët.

---



## PERFORMANCA E SISTEMIT TË SHFRYTEZIMIT MINERAR TË MERMERËVE

Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse të nxisin një qasje të përgjegjshme ndaj menaxhimit të burimeve minerare dhe mbrojtjes së mjedisit, duke kërkuar një harmonizim të ligjit, përdorimin e teknologjisë dhe praktikave të mira për të siguruar një përdorim efektiv dhe të qëndrueshëm të këtyre burimeve. Përdorimi i instrumenteve të nevojshëm është detyrë parësore e tyre me qëllim maksimizimin e vjeljes së rentës minerare, sinkronizimin e legjislacionit minerar me atë të taksave kombëtare, marrjen e masave të nevojshme për miratimin e heqjes nga fondi pyjor të sipërfaqeve pyjore të dhëna për shfrytëzim si dhe kryerjen e rehabilitimit progresiv mjedisor aty ku është e mundur.



## **NDIHMA JURIDIKE FALAS PËR PERSONAT NË NEVOJË**

Garantimi i aksesit të barabartë në drejtësi për personat në nevojë sigurohet nëpërmjet ndërgjegjësimit të qytetarëve për të drejtat e tyre dhe ofrimit të një shërbimi cilësor të asistencës ligjore. Për realizimin e këtij qëllimi, kërkohet një angazhim më i madh i Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas në kryerjen e monitorimeve efektive ndaj ofruesve të ndihmës juridike parësore dhe dytësore, i cili do të mundësonte nxitjen dhe përmirësimin e vazhdueshëm të sistemit dhe garantimin e kushteve infrastrukturore në përputhje me standardet e miratuara.

---



## **PERFORMANCA E OFRIMIT TË SHËRBIMEVE ON-LINE**

Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit dhe institucionet e tjera të përfshira në procesin e digjitalizimit duhet të sigurojnë zgjidhjet më të mira për qytetarët dhe bizneset, në përputhje me standardet teknologjike dhe protokollet e komunikimit të ndryshme, orientimit të drejtë të planifikimit dhe shpërndarjes së fondeve të buxhetit, investimeve si dhe transferimit të infrastrukturave të sistemit të TI.

---




## **GARANTIMI I MBROJTJES SË TË DREJTËS SË AUTORIT**

Ministria e Kulturës, institucionet shtetërore dhe organizatat joqeveritare, duhet të rrisin më shumë bashkëveprimin për, mbrojtjen, promovimin dhe garantimin e të drejtës së autorit nëpërmjet, forcimit të legjislacionit, harmonizimit të praktikave më të mira ndërkombëtare dhe marrjen e masave ligjore, nëse vepra e tij kopjohet, përdoret pa leje, ose shkelet ndonjë aspekt tjetër. E drejta e autorit në vendin tonë, vijon të ketë paqartësi ligjore në kuadrin rregullator ekzistues të cilat kanë sjellë objektiva pjesërisht të realizuara. Përafrimi i vonuar me direktivat e BE – së, mungesa e një strategjie të dedikuar, mungesa e marrëveshjeve dhe koordinimit ndër-institucional, kanë shkaktuar mbivendosje kompetencash midis institucioneve përgjegjëse, lidhur me administrimin, monitorimin/inspektimin, tejkalimin e kostove të administrimit të Agjencive të Administrimit Kolektiv të Drejtave, në raport me nivelin e shpërndarjeve të shpërblimeve tek mbajtësit e të drejtave të autorit. Mosrespektimi i detyrimeve të licencave të Agjencive të Administrimit Kolektiv, mungesa e transparencës dhe besueshmërisë ndërmjet autorëve dhe agjencive, mungesa e gjurmimit dhe evidentimit të përdoruesve të veprave, nuk garantojnë administrim korrekt dhe mbrojtje efektive të së drejtës së autorit.

## 4. NIVELI I PRANUESHMËRISË SË REKOMANDIMEVE\*

Gjatë vitit 2023, Kontrolli i i Lartë i Shtetit ka rekomanduar 4291 masa, nga të cilat 3293 janë masa organizative, 42 janë masa për ndryshime apo përmirësime ligjore, 267 masa shpërblim dëmi, 641 masa me efekte negative për shkak të parregullsive dhe 48 masa si pasojë e mangësive të konstatuara në aktivitetin kontrollues tatimor & doganor, me ndikim negativ në performancën e administrimit të të ardhurave tatimore/doganore.

**Infografik nr. 8:** Pranueshmëria e masava sipas llojit



\* Pa përfshirë masat disiplinore dhe administrative pasi statusi i tyre do të shikohet përgjatë zbatimit të rekomandimeve

\*\* Për subjektet që nuk kanë sjellë përgjigje brenda 20 ditëve sipas nenit 15, shkronja j të ligjit nr. 154/2014, "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", automatikisht statusi i rekomandimeve konsiderohet "i pranuar".

Nga 4291 masa në total, janë pranuar 4273 masa ose rreth 99.6% e masave të rekomanduara dhe nuk janë pranuar 18 masa ose 0.4% e masave të rekomanduara.

Konkretisht:

- nga 3293 masa organizative, janë pranuar 3279 masa ose 99.6% e masave të rekomanduara dhe 14 masa pa pranuar ose 0.4%;
- nga 42 masa për ndryshime ligjore apo përmirësime ligjore janë pranuar 42 masa ose 100% e masave të rekomandura;
- nga 267 masa shpërblim dëmi janë pranuar 263 masa ose 98% e masave të rekomandura dhe 4 masa pa pranuar ose 2%;
- nga 641 masa 3-E, efekte negative për shkak të parregullsive janë pranuar 641 masa ose 100% e masave të rekomanduara;
- nga 48 masa mangësi në aktivitetin kontrollues tatimore me ndikim negativ në performancën e administrimit të të ardhurave tatimore dhe doganore janë pranuar 48 masa ose 100%.

## 5. ZHVILLIMI & MENAXHIMI I BURIMEVE NJERËZORE

### 5.1 Struktura dhe Organika

Gjatë vitit 2023, KLSH ka vijuar të adresojë menaxhimin e burimeve njerëzore në linjë me objektivat e përcaktuara në Dokumentin e Politikave të Burimeve Njerëzore dhe në funksion të realizimit të mbulimit me auditim sipas detyrimeve ligjore.


Në fund të periudhës raportuese, numri faktik i punonjësve është 216 punonjës, nga të cilët 165 janë staf auditues (ose 76.3% e numrit total të punonjësve) të përbërë nga:

- 16 kryeauditues
- 32 auditues të lartë
- 82 auditues të parë
- 35 auditues të dytë

Gjatë vitit 2023, në KLSH:


- janë rekrutuar 26 punonjës të rinj sipas procedurave të ligjit të nëpunësit civil dhe 5 punonjës referuar përcaktimeve të Kodit të Punës; si dhe
- kanë ndërprerë marrëdhëniet administrative me KLSH-në, punonjës, si rezultat i mbushjes së moshës për pension pleqërie, pezullim statusi për shkak të angazhimeve jashtë institucionit (projekte, kualifikime, shëndetësore), dorëheqje, etj.

Infografik nr. 9: Organizimi i Burimeve Njerëzore



## 5.2 Trajnimet

Gjatë periudhës Janar - Dhjetor 2023, u realizuan 207 tema trajnimesh, nga të cilat 99 organizuar nga ASPA dhe 108 nga KLSH & partnerë ndërkombëtarë si EUROSAI, IDI, ECA, GAO, SAI i Norvegjisë, ANAC, OECD, etj. U trajnuan gjithsej 196 auditues, duke realizuar në total 4,854 ditë-njerëz trajnime, nga të cilat 4,465 ditë për 168 staf auditues dhe 389 për 28 staf jo-auditues; ose realizuar mesatarisht rreth 27 ditë trajnimi/auditues (nga 20-25 ditë trajnimi që është objektivi vjetor), dhe 14 ditë trajnimi për staf jo-auditues.



Gjatë këtij viti rreth 63% e trajnimeve u realizuan në sallë, me prezencë fizike, ndërsa 37% e tyre on-line.

Ndër temat kryesore objekt trajnimi gjatë vitit 2023, rendisim:

- tema që prekin çështjet mjedisore,
- tema mbi auditimet e burimit të sistemeve,
- forcimi i kapaciteteve audituese për auditimin e koncesioneve/PPP-ve,
- siguria e informacionit dhe krimi kibernetik,
- të shkruarit e raporteve,
- menaxhimi i cilësisë së auditimit,
- çështje që lidhen me disiplinën buxhetore,
- metodologji mbi auditimin e bashkive,
- risku i korrupsionit në fushën e prokurimit publik,

çështje që lidhen me auditimin e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm, apo me auditimin e prokurimeve publike etj.

**Infografik nr. 10:** Ditët e trajnimeve për stafin auditues

Treguesit e Trajnimeve Janar-Dhjetor 2023	Total 4854 ditë njerëz trajnime	Total 207 tema
KLSH	2660 ditë njerëz	55 tema
Partnerë Ndërkombëtarë	999 ditë njerëz	44 tema
ASPA & trajnime vendase	1195 ditë njerëz	108 tema

## 6. PROGRAMI I TRANSPARENCËS DHE E DREJTA PËR INFORMIM


Kontrulli i Lartë i Shtetit vijon të shqyrtojë me korrektësi dhe profesionalizëm të gjitha ankesat, denoncimet dhe kërkesat për informacion të ardhura nga qytetarët dhe media të ndryshme. Konkretisht, gjatë periudhës Janar - Dhjetor 2023, ka administruar 368 letra nga qytetarët dhe palët e ndryshme të interesit në formën e ankesave apo denoncimeve.

Numri më i madh i këtyre ankesave ka marrë një përgjigje brenda afateve kohore të përcaktuara në ligj. Një pjesë e tyre mbeten në proces verifikimi në auditime të radhës sipas tematikave përkatëse, në përfundim të të cilave KLSH informon menjëherë qytetarin.

Ndërkohë, ankesa të vlerësuara jashtë fushës së kompetencave të KLSH-së, i janë dërguar për kompetencë institucioneve përgjegjëse ose është orientuar qytetari nëpërmjet përgjigjeve zyrtare se cilit institucion duhet t'i drejtohet për të marrë përgjigje lidhur me problematikën që trajton.

Gjithashtu, në bazë të ligjit Nr. 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit", Kontrulli i Lartë i Shtetit gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2023, ka trajtuar 28 kërkesa për informacion të ardhura nga qytetarë, deputetë dhe përfaqësues të medias. Këto kërkesa kanë qenë kryesisht kërkesa mbi vënien në dispozicion të raporteve të ndryshme të auditimit të kryera nga KLSH dhe janë përcjellë tek kërkuesi brenda afateve ligjore të përcaktuara,

**Infografik nr. 11:** Nr i ankesave, denoncimeve dhe kërkesave administruar në KLSH, janar - gusht, 2023



## 7. AUDITIME NË MEDIA



Veprimtaria audituese e KLSH-së vijon të ketë pasqyrim masiv si në median tradicionale, shtypin e shkruar dhe televizion, ashtu edhe në mediat online.

Gjatë periudhës Janar - Dhjetor 2023, janë publikuar 480 artikuj në shtypin e shkruar, si dhe 1756 artikuj e kronika televizive në median audio-vizive dhe online, ku trajtohen gjetjet dhe rekomandimet e lëna nga KLSH në subjektet e audituara.

Gjatë periudhës Janar - Prill 2023, pati pasqyrim të veçantë në media (me rreth 40 artikuj), auditimi i kryer në *Qendrën e Personave me Aftësi të Kufizuara, Bashkia Vlorë* dhe problematikat që ai trajtoi lidhur me trajtimin e rezidentëve që marrin shërbim në këtë qendër, si edhe alokimin e fondeve në drejtim të përmbushjes së nevojave dhe krijimin e kushteve optimale për rehabilitimin e personave me aftësi të kufizuara.

Gjatë periudhës Maj - Gusht 2023, raportet e auditimit që kanë pasur pasqyrim masiv në media i përkasin çështjeve që lidhen me *koncesionet në sistemin shëndetësor*, si: check-up, shërbimi laboratorik në spitale, sterilizimi i instrumenteve kirurgjikale etj, ku ndër to përmendim raportin e auditimit të performancës me temë "*Trajtimi i sëmundjeve tumorale*" (rreth 100 artikuj), në të cilin paraqitet situata në Spitalin Onkologjik të Tiranës pranë Qendrës Spitalore Universitare "Nënë Tereza" dhe spitalet rajonale lidhur me shërbimet që ofrohen për pacientët me sëmundje tumorale.

Ndërsa gjatë periudhës Shtator - Dhjetor 2023, patën pasqyrim të gjerë në media, raporti i auditimit me temë "*Rezervat materiale të shtetit në shërbim të qytetarit*", ku diktohet nevoja që asetet e trashëguara, pasuri kombëtare të administrohen për të qenë një vlerë e shtuar në rezervën materiale të shtetit si dhe përmbushja e kufijve minimalë të përcaktuar të rezervës materiale e shtetit, duhet të jetë garanci për qytetarin. Ndërsa sa i takon auditimit me temë "*Ndikimi i mjeteve të transportit rrugor në cilësinë e ajrit*", i cili gjithashtu ka pasur jehonë në media, janë trajtuar çështje që nxisin rinovimin e flotës së mjeteve rrugore, vënien në zbatim të stimuljeve financiare për të shtuar numrin e mjeteve rrugore me emetim të ulët, plotësimin e legjislacionit në përputhje me praktikatat më të mira ndërkombëtare si dhe forcimin e mëtejshëm të sistemit të monitorimit të cilësisë së ajrit.

## 8. ANEKSE

### ANEKS 1: AUDITIMET SIPAS LLOJIT

Tabela 1: Misionet e auditimit në numër, sipas llojit

Lloji i auditimit	Nr.auditimesh	Pesha në %
Financiar & Perputhshmërie	121	75.7%
Performance	17	10.6%
IT	8	5%
Përputhshmërie (për çështje të veçanta)	14	8.7%
<b>Total auditime</b>	<b>160</b>	<b>100%</b>

